



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

**14 MAJ 2023**

# **KUJTESË**

**PËR KOMISIONIN E QENDRËS  
SË VOTIMIT NË DITËN E ZGJEDHJEVE**



1. Sigurohuni që kamera është në funksion dhe pasqyron veprimtarinë në QV në mënyrë transparente duke u kujdesur për ruajtjen e fshehtësisë së votës.
2. Kontrolloni materialet që gjenden në kutinë e materialeve zgjedhore.
3. Sekretar, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, shëno dhe plotëso çdo veprim, a ngjarje që ndodh në Qendrën tënde të Votimit.
4. Hiqni materialet propagandistike në mjedisin e votimit deri në rrezen 150 m nga qendra e votimit.
5. Përgatisni qendrën e votimit për procesin e votimit.
6. Vendosni në Qendrën e votimit, Flamurin Kombëtar.
7. Afishoni posterat informues të marra në dorëzim prej jush nga KZAZ.
8. Dorëzoni operatorit, pajisjen PEI dhe dokumentojeni këtë veprim përmes plotësimit të procesverbalit përkatës.
9. Sekretar, logohu në aplikacionin KQZ dhe raporto përmes këtij aplikacioni.
10. Merrni vendimin për ndarjen e detyrave të anëtarëve të KQV.
11. Tregojuni vëzhguesve kutitë bosh të votimit.
12. Vulosni me nga 4 kode me vula sigurie secilën prej kutive të votimit në mënyrë të atillë që të mos ketë hapërsirë mes kapakut dhe kutisë së votimit.
13. Konfirmojini operatorit të pajisjes PEI, të dhënat e Qendrës së Votimit.
14. Nënshkruani raportin e hapjes së procesit të identifikimit elektronik të printuar nga PEI.
15. Plotësoni procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit, KQZ-00-07.
16. Kujdes, futni në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë, origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutive të votimit, pasi ta keni futur më parë në zarfin e procesverbalit të vulosjes.
17. Merrni vendim për hapjen e votimit duke plotësuar vendimin model të miratuar nga KSHZ.
18. Kryetar, deklaro hapjen e votimit në orën 7.00.
19. Kryeni veprimet me zgjedhësit, sipas detyrave që keni ndarë.
20. Orientoni zgjedhësin me aftësi të kufizuar në dhomën e fshehtë të veçantë.
21. Sekretar, vulos fletën e votimit, në anën e pasme të saj, në fund, me vulën e KQV.
22. Kryetar, vulos fletën e votimit, në anën e pasme të saj, në fund, me vulën e kryetarit.
23. Kryetar, administro dokumentin fizik të identifikimit elektronik të zgjedhësit të printuar nga PEI.
24. Njoftoni, në rast incidentesh, KZAZ dhe merrni vendimin për pezullimin e votimit dhe njoftimin e policisë së shtetit për rivendosjen e rendit.
25. Sekretar, shëno me detaje në librin e protokollit të mbledhjeve, rastet e incidenteve, duke evidentuar orën e saktë të paraqitjes së policisë së shtetit.

26. Merrni vendimin për rifillimin e votimit dhe vendimin për largimin e policisë së shtetit, pas rivendosjes së rendit.
27. Sekretar, shëno, në librin e protokollit të mbledhjeve, orën e saktë të largimin të policisë së shtetit nga mjediset e QV.
28. Mbyllni votimin në orën 19.00.
29. Mblidhni kartat e identitetit të zgjedhësve që janë në radhë për të votuar, në orën 19.00.
30. Si anëtarë të KQV, kryeni votimin në qendrën ku po ushtroni detyrën.
31. Lejoni operatorin /personin e ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerave, të votojë në qendrën e votimit, edhe pse nuk është zgjedhës në atë qendër votimi, por është zgjedhës i asaj zone zgjedhore.
32. Merrni vendimin për mbylljen e votimit dhe plotësoni vendimin model për mbylljen e votimit të miratuar nga KQZ.
33. Nënshkruani raportin e printuar nga pajisja PEI për mbylljen e votimit dhe futeni atë në kutinë e materialeve zgjedhore të QV.
34. Kryetar deklaro të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit, mbështetur në të dhënat e marra nga Raporti i Mbylljes së pajisjes PEI.
35. Kryetar deklaro numrin e fletëve të votimit të papërdorura, dhe pasqyroni këtë shifër në procesverbalin përkatës.
36. Futni në zarfin e fletëve të papërdorura, fletët e votimit të papërdorura.
37. Kryetar deklaro numrin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe pasqyroni në procesverbalin përkatës numrin e fletëve të votimit të dëmtuara.
38. Futni në zarfin përkatës fletët e votimit të dëmtuara.
39. Plotësoni procesverbalin e mbylljes së votimit model KQZ-00-08.
40. Kujdes! Futni në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë origjinalin e procesverbalit të mbylljes së votimit pasi ta keni futur më parë në zarfin përkatës.
41. Futni kopje të procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit për këshill të bashkisë dhe në kutinë e materialeve të votimit.
42. Futni, raportin e mbylljes së printuar automatikisht nga PEI në kutinë e materialeve të votimit.
43. Mbyllni dritaret e kutive së votimit me kodet me vulat së pestë të sigurisë.
44. Futni çdo material tjetër në kutinë e materialeve zgjedhore.
45. Mbyllni kutinë e materialeve zgjedhore me kodet me vulat e sigurisë të paracaktuara dhe të evidentuara në procesverbalin e mbylljes së votimit.
46. Merrni kutitë e votimit dhe atë të materialeve zgjedhore dhe nisuni për në KZAZ tuaj, shoqëruar nga punonjësi i policisë.
47. Nënshkruani procesverbalin përkatës në dorëzimin e kutive në KZAZ.



Për ndihmë nga KQZ telefono pa pagesë në

**0800 0803**

**Skano QR Code** më poshtë për Telegram dhe Whatsapp për te marrë udhëzimet & informacionet në kohë reale nga KQZ



SHKARKO, në telefonin tënd celular aplikacionin "KQZ", për të marrë informacion dhe për të raportuar në KQZ, sipas udhëzimeve përkatëse.

